

LIGJ
Nr.9316, datë 18.11.2004

PËR ADERIMIN E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË NË KONVENTËN NDËRKOMBËTARE
“PËR ASISTENCË TË NDËRSJELLË ADMINISTRATIVE NË ÇËSHTJET DOGANORE”

Në mbështetje të neneve 78, 83 pika 1 dhe 121 pika 1 të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

Neni 1

Republika e Shqipërisë aderon në Konventën Ndërkombëtare “Për asistencë të ndërsjellë administrative në çështjet doganore”, bërë në Bruksel më 27 qershor 2003.

Neni 2

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Shpallur me dekretin nr.4418, datë 14.12.2004 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë, Alfred Moisiu

ORGANIZATA BOTËRORE E DOGANAVE

PREAMBUL

Palët Kontraktuese në këtë Konventë, themeluar nën mbikëqyrjen e Këshillit të Kooperimit Doganor, tani e njohur si Organizata Botërore e Doganave,

duke ditur se bashkëpunimi më i ngushtë ndërmjet administratave doganore është një synim primar i Konventës që ka themeluar një këshill të kooperimit doganor,

të bindur se bashkëpunimi më efektiv ndërmjet administratave doganore mund të arrihet nëpërmjet vullnetit të mirë të Palëve Kontraktuese,

duke marrë në konsideratë rëndësinë e përcaktimit të saktë të detyrimeve doganore dhe taksave të tjera dhe të sigurimit të ushtrimit të saktë nga administratat doganore të ndalimeve, kufizimeve dhe masave të kontrollit në lidhje me mallra të caktuara,

duke marrë në konsideratë se shkeljet ndaj ligjeve doganore janë të dëmshme për sigurinë e Palëve Kontraktuese dhe për interesat e tyre ekonomike, tregtare, fiskale, shoqërore, kulturore dhe të shëndetit publik,

duke marrë në llogari kërcënimin e krimit ndërkombëtar të organizuar dhe të grupeve terroriste me resorset e tyre thelbësore dhe nevojën për t'i luftuar efektivisht ato,

duke njohur shqetësimin e rritur global për sigurinë dhe lehtësimin e rrjetit ndërkombëtar të furnizimit tregtar dhe Rezolutën e Këshillit të Kooperimit Doganor të qershorit 2002 lidhur me këtë,

duke njohur rëndësinë e arritjes së një ekulibri ndërmjet zbatimit të ligjit dhe lehtësimit për të siguruar lëvizjen e lirë të tregtisë së ligjshme dhe për të arritur nevojat e qeverive për mbrojtjen e shoqërisë dhe të të ardhurave,

të bindur se tregtia ndërkombëtare do të lehtësohet nëpërmjet adoptimit të teknikave moderne të kontrollit, si menaxhimi i riskut nga administratat doganore,

duke ditur se shkëmbimi ndërkombëtar i informacionit është një komponent thelbësor i

menaxhimit efektiv të riskut dhe se një shkëmbim i tillë informacioni duhet të bazohet në dispozita të qarta ligjore,

duke marrë në konsideratë Konventën ndërkombëtare mbi ndihmën e ndërsjellë administrative për parandalimin, hetimin dhe goditjen e shkeljeve doganore, adoptuar në Nairobi më 9 qershor 1997 nën mbikëqyrjen e Këshillit të Kooperimit Doganor, i cili shtron një strukturë për lehtësimin e ndihmës së ndërsjellë administrative në çështjet doganore,

duke marrë në konsideratë Konventën e Kombeve të Bashkuara kundër krimit transnacional të organizuar, adoptuar në Nju-Jork më 15 nëntor 2000 dhe për të cilën u mbajt Konferenca Nënshkruese Politike e Nivelit të Lartë në Palermo më 12-15 dhjetor 2000, e cila shtron strukturën për ndihmë të ndërsjellë ndërkombëtare në çështjet kriminale me synim parandalimin dhe luftën ndaj krimit të organizuar transnacional;

duke marrë në konsideratë konventat ndërkombëtare që përfshijnë ndalimet, kufizimet dhe masat e kontrollit lidhur me mallra të caktuara,

duke marrë paraysh Deklaratën Universale të Kombeve të Bashkuara për të Drejtat e Njeriut të 1948;

Ranë dakord për sa më poshtë vijon:

KAPITULLI I PËRKUFIZIME

Neni 1

Për qëllimet e kësaj Konvente:

a) “Komitet Administrativ” do të thotë Komiteti Përgjegjës për Menaxhimin e kësaj Konvente siç përcaktohet në nenin 45;

b) “Këshill” do të thotë organizata e ngritur nga Konventa themeluese e Këshillit të Kooperimit Doganor, kryer në Bruksel më 15 dhjetor 1950 dhe hyrë në fuqi më 4 nëntor 1952;

c) “Zyrtar i Këshillit” do të thotë çdo zyrtar apo punonjës i Këshillit dhe çdo person tjetër i caktuar nga Sekretari i Përgjithshëm për të kryer funksionet në zbatim të kësaj Konvente;

d) “Bashkëpunim ndërkufitar” do të thotë bashkëpunimi ndërmjet administratave doganore të Palëve Kontraktuese ndërmjet kufijve të tyre respektivë;

e) “Administratë doganore” do të thotë autoriteti doganor dhe çdo autoritet tjetër i Palëve Kontraktuese i autorizuar sipas legjislacionit kombëtar nga kjo Palë Kontraktuese për të zbatuar dispozitat e kësaj Konvente;

f) “Pretendime doganore” do të thotë çdo sasi e detyrimeve doganore të cilat nuk mund të grumbullohen në njërën prej Palëve Kontraktuese;

g) “Detyrime doganore” do të thotë të gjitha detyrimet, taksat, kuotat dhe të tjera të cilat ushtrohen në territoret e Palëve Kontraktuese në zbatim të ligjit doganor, por që nuk përfshijnë taksa dhe detyrime të tjera për shërbimet e kryera;

h) “Ligj doganor” do të thotë çdo dispozitë ligjore apo administrative e zbatuar apo e ushtruar nga administrata doganore e një Palë Kontraktuese lidhur me importimin, eksportimin, transitin, transngarkimin, magazinimin dhe lëvizjen e mallrave, duke përfshirë dispozitat ligjore dhe administrative lidhur me masat e ndalimit, kufizimit dhe kontrollit, dhe për të luftuar larjen e parave;

i) “Shkelje doganore” do të thotë çdo shkelje ose përpjekje për shkelje të ligjit doganor të një Palë Kontraktuese;

j) “Union Ekonomik ose Doganor” do të thotë një bashkim, i konstituar dhe përbërë nga anëtarë, i cili ka kompetencë të adoptojë rregullat e veta të cilat janë të detyrueshme për anëtarët e vet në respekt të çështjeve të trajtuara nga kjo Konventë, dhe ka kompetenca të vendosë, në përputhje me procedurat e veta të brendshme për të firmosur, ratifikuar apo hyrë në këtë Konventë;

k) “Komiteti i Antikontrabandës” do të thotë Komiteti i Antikontrabandës së Këshillit;

l) “Informacion” do të thotë çdo e dhënë, e përpunuar dhe analizuar ose jo, si dhe dokumente, raporte, dhe komunikime të tjera në çdo format, përfshirë ato elektronike, ose kopje të certifikuara dhe të autentifikuara të këtyre;

m) “Rrjeti ndërkombëtar i furnizimit të tregtisë” do të thotë të gjitha proceset e përfshira në lëvizjen ndërkufitare të mallrave nga vendi i origjinës deri në vendin e destinacionit final;

n) “Nëpunës” do të thotë çdo zyrtar i doganës ose agjentë të tjerë qeveritarë të caktuar nga një administratë doganore;

o) “Person” do të thotë si person fizik, ashtu edhe person juridik, me përjashtim të rasteve kur konteksti nënkupton diçka tjetër;

p) “Të dhëna personale” do të thotë çdo e dhënë lidhur me një person fizik të identifikuar apo të identifikueshëm;

q) “Ratifikim” do të përfshijë pranimin ose aprovimin;

r) “Administratë kërkuese” do të thotë administrata doganore që kërkon ndihmë;

s) “Administratë e kërkuar” do të thotë administrata doganore nga e cila kërkohet ndihmë;

t) “Palë Kontraktuese kërkuese” do të thotë Pala Kontraktuese, administrata doganore e së cilës kërkon ndihmë;

u) “Palë Kontraktuese e kërkuar” do të thotë Pala Kontraktuese, administrata doganore e së cilës kërkohet të mundësojë ndihmë;

v) “Sekretar i Përgjithshëm” do të thotë Sekretari i Përgjithshëm i Këshillit.

KAPITULLI II

FUSHËMBULIMI I MARRËVESHJES

Neni 2

1. Palët Kontraktuese, nëpërmjet administratave të tyre doganore, do t’i mundësojnë njëra-tjetrës ndihmë administrative sipas termave të vendosura në këtë Konventë, për zbatimin e saktë të legjislacionit doganor, për parandalimin, hetimin dhe luftën ndaj shkeljeve doganore, si dhe për të garantuar sigurimin e rrjetit ndërkombëtar të furnizimit tregtar.

2. Çdo aktivitet i kryer sipas kësaj Konvente nga Palët Kontraktuese do të jetë në përputhje me dispozitat ligjore dhe administrative dhe brenda limiteve të kompetencave dhe resorçeve të mundshme të administratës së vet doganore.

3. Çdo Palë Kontraktuese do të njoftojë Sekretarin e Përgjithshëm për autoritetet e përmendura në nenin 1(e), të autorizuar sipas legjislacionit kombëtar dhe të caktuara nga kjo Palë Kontraktuese për të zbatuar çdo dispozitë të kësaj Konvente. Sekretari i Përgjithshëm do t’ua komunikojë këtë informacion, si dhe zhvillimet e reja lidhur me këtë Palëve të tjera Kontraktuese.

4. Kjo Konventë mbulon vetëm ndihmën e ndërsjellë administrative ndërmjet Palëve Kontraktuese dhe nuk synon të ketë pasoja mbi marrëveshjet e ndihmës së ndërsjellë ligjore ndërmjet tyre. Nëse ndihma e ndërsjellë do të mundësohet nga autoritete të tjera të Palës Kontraktuese të kërkuar, administrata e kërkuar do të ndikojë këto autoritete dhe kur njihen marrëveshjet apo rregullimet e zbatueshme.

5. Dispozitat e kësaj Konvente nuk do t’i japin të drejtë një Pale për ndonjë person që të pengojë ekzekutimin e kërkesës për ndihmë.

KAPITULLI III

PROCEDURAT E NDIHMËS SË PËRGJITHSHME

Neni 3

Komunikimi i kërkesave

1. Kërkesat për ndihmë sipas kësaj Konvente do të komunikohen direkt ndërmjet

administratave doganore të interesuara. Secila administratë doganore do të caktojë një pikë zyrtare kontakti për këtë qëllim dhe këto të dhëna do t'i jepen Sekretarit të Përgjithshëm. Sekretari i Përgjithshëm do t'ua komunikojë këtë informacion, si dhe çdo rifreskim të këtij informacioni administratave të tjera doganore.

2. Kërkesat për ndihmë sipas kësaj Konvente do të bëhen me shkrim ose në rrugë elektronike dhe do të shoqërohen nga një informacion që konsiderohet i nevojshëm për qëllimin e përmbushjes së kërkesës. Administrata e kërkuar mund të kërkojë konfirmim me shkrim të kërkesës elektronike. Kur e kërkojnë situatat, kërkesa mund të bëhet me gojë. Një kërkesë e tillë duhet të konfirmohet sa më shpejt të jetë e mundur me shkrim ose nëse pranohet nga administrata e kërkuar, me rrugë elektronike.

3. Kërkesat duhet të bëhen në një gjuhë të pranueshme nga administrata doganore e interesuar. Çfarëdolloj dokumenti shoqërues i kërkesës do të përkthehet për aq sa është e nevojshme në një gjuhë reciprokisht të pranuar. Administrata e kërkuar gjithsesi do ta pranojë kërkesën për ndihmë dhe dokumentet shoqëruese, në njërën prej gjuhëve zyrtare të Këshillit të cilën ajo përcakton.

4. Kërkesat e bëra në përputhje me paragrafin 2 të këtij neni do të përmbajnë detajet e mëposhtme:

- a) emrin e administratës kërkuuese;
- b) çështjen, llojin e ndihmës së kërkuar dhe arsyet për kërkesën;
- c) një përshkrim të përmbledhur të çështjes, si dhe dispozitat ligjore dhe administrative që zbatohen;
- d) emrat dhe adresat e personave me të cilët ka të bëjë çështja nëse dihen;
- e) një referencë në përputhje me paragrafin 2 të nenit 42, nëse aplikohet;
- f) verifikimet e bëra në përputhje me paragrafin 2 të nenit 7.

5. Kur administrata kërkuuese kërkon që të ndiqet një procedurë apo metodologji e caktuar, administrata e kërkuar do t'i përgjigjet kërkesës kushtëzuar nga dispozitat e veta kombëtare ligjore dhe administrative.

Neni 4 **Ndihma spontane**

Për rastet që përfshijnë dëme thelbësore për ekonominë, shëndetin publik, sigurinë publike, duke përfshirë sigurinë e rrjetit ndërkombëtar të furnizimit të tregtisë, ose interesa të tjera vitale të një Palë Kontraktuese, administrata doganore e një Palë Kontraktuese, sa herë të jetë e mundur do të furnizojë me ndihmë sipas iniciativës së vet dhe pa vonesë.

KAPITULLI IV INFORMACIONI

Neni 5 **Informacion për zbatimin dhe ushtrimin e ligjit doganor**

Administratat doganore do t'i mundësojnë njëra-tjetrës sipas kërkesës ose me iniciativën e vet, informacion i cili ndihmon për të siguruar zbatimin e saktë të ligjit doganor dhe parandalimin, hetimin dhe luftën ndaj shkeljeve doganore dhe për të garantuar sigurinë e rrjetit ndërkombëtar të furnizimit të tregtisë. Ky informacion duhet të përmbajë:

- a) teknika te reja antikontrabandë të cilat kanë treguar efektivitetin e tyre;
- b) tendenca të reja, mjete dhe metoda për kryerjen e shkeljeve doganore;
- c) mallra të njohura si subjekt i shkeljeve doganore, si dhe metoda transporti dhe magazinimi të përdorura lidhur me këto mallra;
- d) persona të njohur se kanë kryer një shkelje doganore ose të dyshuar se janë gati të kryejnë një shkelje doganore;
- e) të dhëna të tjera që mund të asistojnë administratat doganore mbi përcaktimin e riskut për qëllime kontrolli dhe lehtësimi.

Neni 6

Informacioni lidhur me shkeljet doganore

Administrata doganore e një Pale Kontraktuese do t'i mundësojë administratës doganore të një Pale tjetër Kontraktuese të interesuar, sipas iniciativës ose sipas kërkesës, informacion mbi veprime të planifikuara, në vazhdim apo të kryera, të cilat japin baza të arsyeshme për të besuar se është kryer ose do të kryhet një shkelje doganore në territorin e Palës Kontraktuese të interesuar.

Neni 7

Informacion mbi përcaktimin e detyrimeve dhe taksave të importit ose eksportit

1. Sipas kërkesës, administrata e kërkuar, pa paragjykuar nenin 42, në mbështetje të zbatimit të saktë të ligjit doganor ose për parandalimin e kontrabandës, do të mundësojë informacion për të ndihmuar administratën e kërkuar, e cila ka arsye për të dyshuar mbi vërtetësinë apo origjinalitetin e një deklarate.

2. Kërkesa do të specifikojë procedurat e verifikimit për të cilat është përpjekur apo ka ndërmarrë administrata kërkuuese, si dhe informacionin specifik të kërkuar.

Neni 8

Lloje të veçanta informacioni

Sipas kërkesës, administrata e kërkuar do t'i mundësojë administratës kërkuuese, e cila ka arsye të dyshojë mbi vërtetësinë e informacionit të dhënë asaj mbi një çështje doganore, informacion:

a) nëse mallrat e importuara në territorin e Palës Kontraktuese kërkuuese janë eksportuar në mënyrë të ligjshme në territorin e Palës Kontraktuese të kërkuar;

b) nëse mallrat e eksportuara nga territori i Palës Kontraktuese kërkuuese janë importuar ligjërisht në territorin e Palës Kontraktuese të kërkuar, si dhe procedurat doganore, nëse ka, nën të cilat janë vendosur mallrat.

Neni 9

Shkëmbimi automatik i informacionit

Palët Kontraktuese, sipas rregullimeve të ndërsjella në përputhje me paragrafin 2 të nenit 48, mund të shkëmbejnë informacion të mbuluar nga kjo Konventë, mbi baza automatike.

Neni 10

Shkëmbimi paraprak i informacionit

1. Palët Kontraktuese, nëpërmjet rregullimeve të ndërsjella në përputhje me paragrafin 2 të nenit 48, mund të shkëmbejnë informacion specifik para mbërritjes së ngarkesave në territoret e tyre respektive për të garantuar në veçanti, sigurinë e rrjetit ndërkombëtar të furnizimit të tregtisë.

2. Një informacion i tillë, sa më shumë që të jetë e mundur, duhet të përmbajë të dhënat e mëposhtme:

- i) Dërguesin ose kodin e dërguesit, eksportuesin ose kodin e eksportuesit;
- ii) Përshkrimin e mallrave ose numrin e kodit tarifor;
- iii) Numrin UNDG (kodin e mallrave të rrezikshme);
- iv) Identifikimin e tipit të paketimit;
- v) Numrin e pakove;
- vi) Vlerësimin e njësisë matëse;
- vii) Peshën totale gross;
- viii) Sasinë totale të faturës;
- ix) Kodin e valutës;
- x) Vendin e ngarkesës ose kodin e vendit të ngarkesës;
- xi) Identifikimin e transportuesit ose emrin e transportuesit;
- xii) Numrin identifikues të pajisjeve;

xiii) Masën e pajisjeve dhe identifikimin e tipit;
xiv) Numrin e plumbçes;
xv) Identifikimin e mjeteve të transportit që kalojnë kufirin e një Palë Kontraktuese ose kodin;
xvi) Kombësinë e mjeteve të transportit që kalojnë kufirin e territorit të Palës Kontraktuese ose kodin;
xvii) Numrin e referencës së ngarkesës;
xviii) Kodin ose metodën e pagesës së detyrimeve të transportit;
xix) Degën doganore të daljes ose kodin;
xx) Vendet gjatë rrugës ose kodin;
xxi) Portin e parë të mbërritjes ose kodin;
xxii) Datën dhe orën e mbërritjes në portin e parë të mbërritjes në territorin e Palës Kontraktuese ose kodin;
xxiii) Marrësin ose kodin e marrësit ose importuesin ose kodin e importuesit;
xxiv) Palën e njoftuar ose kodin e palës së njoftuar;
xxv) Destinacionin e dërgesës;
xxvi) Agjentin ose kodin e agjentit;
xxvii) Numrin e referencës unike të ngarkesës.

3. Komiteti Administrativ do të ketë autoritetin të modifikojë listën e referuar në paragrafin 2 të këtij neni.

KAPITULLI V LLOJE SPECIALE NDIHME

Neni 11 **Mbikëqyrja**

1. Sipas kërkesë, administrata e kërkuar, për aq sa është e mundur, do të mbajë nën survejim, dhe do t'i mundësojë administratës kërkuese informacion mbi:

- a) mallrat në transport apo magazinim të njohura se janë përdorur ose dyshuar se mund të jenë përdorur për të kryer një shkelje doganore në territorin e Palës Kontraktuese kërkuese;
- b) mjete transporti të njohura se janë përdorur ose të dyshuara se janë përdorur për të kryer një shkelje doganore në territorin e Palës Kontraktuese kërkuese;
- c) vende të njohura se janë përdorur ose të dyshuara se mund të përdoren në lidhje me kryerjen e një shkeljeje doganore në territorin e Palës Kontraktuese kërkuese;
- d) persona të njohur se kanë kryer ose të dyshuar se janë gati për të kryer një shkelje doganore në territorin e Palës Kontraktuese kërkuese, veçanërisht ato që lëvizin për në, apo nga territori i Palës Kontraktuese të kërkuar.

2. Administrata doganore e një Palë Kontraktuese mund të kryejë një survejim të tillë me iniciativën e vet nëse ka arsye të besojë se veprime të planifikuara, në kryerje e sipër ose të përfunduara mund të përbëjnë një shkelje doganore në territorin e një Palë tjetër Kontraktuese.

Neni 12 **Shpërndarja e kontrolluar**

1. Palët Kontraktuese, sipas rregullimeve reciproke në përputhje me paragrafin 2 të nenit 48, mund të lejojnë lëvizjen e mallrave të paligjshme ose të dyshuara që të kalojnë nga, nëpër ose për në territorin e tyre, me njohurinë ose nën kontrollin e administratës doganore, me synimin investigimin dhe goditjen e shkeljeve doganore.

2. Nëse një lëvizje e tillë nuk mund të kryhet nën kontrollin e autoritetit doganor, ky autoritet do të përpiqet të fillojë bashkëpunimin me autoritetet shtetërore të cilat kanë kompetenca të tilla ose do t'ua transferojë çështjen atyre.

Neni 13 **Njoftimet**

1. Sipas kërkesës, administrata e kërkuar, nëse është e lejueshme nën legjislacionin e vet kombëtar, do të ndërmarrë të gjitha masat e nevojshme për të njoftuar një person rezident ose të regjistruar në territorin e vet mbi të gjitha vendimet e marra nga administratë kërkuuese në zbatim të ligjit doganor lidhur me atë person, të cilat bien brenda fushës së mbulimit të kësaj Konvente.

2. Këto njoftime do të bëhen në përputhje me procedurat e zbatueshme në territorin e Palës Kontraktuese të kërkuar për vendime kombëtare të ngjashme.

Neni 14

Rimbursimi i pretendimeve doganore

1. Sipas kërkesës, administratat doganore mund t'i japin njëra-tjetrës ndihmë për rimbursimin e pretendimeve doganore.

2. Rregullimet e nevojshme për ndihmë lidhur me rimbursimin e pretendimeve doganore do të bëhen ndërmjet Palëve Kontraktuese të interesuara, në përputhje me paragrafin 2 të nenit 48.

Neni 15

Ekspertët dhe dëshmitarët

Sipas kërkesës, administrata e kërkuar mund të autorizojë punonjësit e vet për t'u paraqitur përpara një gjykate apo tribunali në territorin e Palës Kontraktuese kërkuuese si ekspertë apo dëshmitarë në një çështje të lidhur me zbatimin e ligjit doganor.

Neni 16

Prania e punonjësve në territorin e një Pale tjetër Kontraktuese

Sipas kërkesës, punonjës të caktuar specifikisht nga një administratë kërkuuese, me autorizimin e administratës së kërkuar dhe kushtëzuar nga konditat që kjo e fundit mund të caktojë, me qëllim investigimin e një shkeljeje doganore:

a) mund të ekzaminojnë, në zyrat e administratës së kërkuar, dokumente dhe informacione të tjera lidhur me shkelje doganore dhe të furnizohen me kopje të këtyre;

b) mund të jenë prezente gjatë një hetimi të kryer nga administrata e kërkuar në territorin e Palës Kontraktuese të kërkuar, e cila ka lidhje me administratën kërkuuese; këta punonjës do të kenë vetëm rol këshillues.

Neni 17

Prania e punonjësve të administratës kërkuuese sipas ftesës së administratës së kërkuar

1. Kur administrata e kërkuar e konsideron të përshtatshme për një punonjës të administratës kërkuuese që të jetë prezent kur, në përputhje me një kërkesë janë duke u ndërmarrë masa ndihme, ajo mund të ftojë pjesëmarrjen e administratës kërkuuese në bazë të termave dhe kushteve që kjo mund të caktojë.

2. Administrata doganore në fjalë mund të zgjerojë rolin e punonjësit vizitues përtej atij të këshillimit, sipas rregullimeve të ndërsjella në përputhje me paragrafin 2 të nenit 48.

Neni 18

Rregullime për punonjësit vizitues

1. Pa paragjykuar nenet 19, 20, 21, 22 dhe 23, kur punonjësit e një Palë Kontraktuese janë prezente në territorin e një Palë tjetër Kontraktuese sipas kushteve të kësaj Konvente, ata në çdo kohë duhet të jenë të aftë të provojnë, në një gjuhë të pranueshme për administratën e kërkuar, identitetin e

tyre zyrtar dhe statusin në administratën e tyre dhe të statusit të tyre zyrtar që u është dhënë në administratën e kërkuar.

2. Punonjësit, gjatë qëndrimit të tyre në territorin e një Palë tjetër Kontraktuese sipas termave të kësaj Konvente, janë përgjegjës për çdo shkelje që mund të kryejnë dhe do të gëzojnë, për aq sa mundësohet nga ligji kombëtar i asaj pale, të njëjtën mbrojtje siç u jepet nëpunësve të vet doganorë.

KAPITULLI VI BASHKËPUNIMI NDËRKUFITAR

Neni 19

Dispozita të përgjithshme

Punonjës të një Pale Kontraktuese, sipas rregullimeve të ndërsjella në përputhje me paragrafin 2 të nenit 48, mund të angazhohen në një nga veprimet e caktuara në këtë kapitull në territorin e një Palë tjetër Kontraktuese dhe në përputhje me kushte shtesë siç mund të caktohen nga Pala Kontraktuese në territorin e së cilës zhvillohen këto veprime. Secila nga këto veprime do të ndalojë në momentin që e kërkon Pala Kontraktuese në territorin e së cilës zhvillohen këto veprime.

Neni 20

Ndjekja e nxehtë

1. Punonjës të një Pale Kontraktuese të cilët ndjekin në territorin e Palës së vet një individ të kapur në aktin e kryerjes së një shkeljeje doganore, e cila jep shkak për ekstradim, ose i cili merr pjesë në një shkelje të tillë, mund të vazhdojnë ndjekjen në territorin e një Pale tjetër Kontraktuese, sipas kushteve të një kërkesë paraprake, autorizimi ose kushtëzimeve të caktuara nga Pala e Kërkuar.

2. Nëse, për shkaqe tejet urgjente, nuk ka qenë e mundur të informohen autoritetet kompetente të një Pale Kontraktuese përpara hyrjes në territorin e saj ose kur këto autoritete nuk kanë pasur mundësi të angazhohen në ndjekje aktive, ndjekja mund të vazhdohet pa autorizim paraprak.

3. Kur ndjekja vazhdon pa autorizim paraprak, autoritetet doganore të Palës Kontraktuese në territorin e së cilës po kryhet ndjekja, duhet të informohen menjëherë mbi kalimin e kufirit dhe duhet të dorëzohet sa më shpejt të jetë e mundur një kërkesë zyrtare autorizimi, duke theksuar arsyet për kalimin e kufirit pa autorizimin paraprak.

4. Sipas kërkesës së punonjësve ndjekës, autoritetet kompetente të Palës Kontraktuese ku po zhvillohet ndjekja do të ndjekin individin e kërkuar në mënyrë që të përcaktohet identiteti apo të gjendet ai/ajo.

5. Kur ndjekja zhvillohet në det, kjo ndjekje, kur zhvillohet në det të hapur, do të kryhet në përputhje me ligjet ndërkombëtare të detit siç paraqiten në Konventën e Kombeve të Bashkuara mbi ligjin për detin.

Neni 21

Mbikëqyrja ndërkufitare

1. Punonjësit e një Pale Kontraktuese, të cilët mbajnë nën survejim në territorin e palës së tyre një person për të cilin ka të dhëna serioze për të besuar se ai apo ajo është i përfshirë në një shkelje doganore, mund të vazhdojnë mbikëqyrjen në territorin e një Pale tjetër Kontraktuese sipas një kërkesë paraprake, autorizimi apo kushteve që Pala Kontraktuese e kërkuar mund të vendosë.

2. Nëse për arsye tejet urgjente, autorizimi paraprak nuk mund të kërkohet, mbikëqyrja në përputhje me paragrafin 1 të këtij neni mund të vazhdohet me kusht që autoritetet kompetente të Palës Kontraktuese në territorin e së cilës do të vazhdojë mbikëqyrja të informohen menjëherë mbi kalimin e kufirit, dhe një kërkesë zyrtare për autorizim, e cila thekson arsyet e kalimit të kufirit pa autorizim paraprak, duhet të paraqitet sa më shpejt të jetë e mundur.

Neni 22
Hetimet e mbuluara

1. Një Palë Kontraktuese e kërkuar mund të autorizojë punonjës të një Palë Kontraktuese kërkuuese të hetojnë në territorin e vet, nën mbulimin e identiteve false, për të siguruar apo sqaruar fakte mbi një shkelje doganore kur është jashtëzakonisht e pamundur për të vepruar ndryshe. Punonjësit në fjalë do të autorizohen të grumbullojnë informacion dhe të kenë kontakt me subjektet e hetimit ose me persona të tjerë të lidhur me ta gjatë veprimtarive hetuese.

2. Këto hetime do të kryhen në përputhje me ligjin dhe procedurat e Palës Kontraktuese në territorin e së cilës zhvillohen hetimet.

Neni 23
Kontrolli dhe ekipet hetuese të përbashkëta

1. Palët Kontraktuese mund të kryejnë kontrole ose ekipe hetuese të përbashkëta për të gjetur dhe parandaluar lloje të veçanta shkeljesh doganore, të cilat kërkojnë veprime të njëkohshme dhe të koordinuara.

2. Këto ekipe do të operojnë në përputhje me ligjin dhe procedurat e Palës Kontraktuese në territorin e së cilës kryhen këto veprime.

KAPITULLI VII
PËRDORIMI, KONFIDENCIALITETI DHE MBROJTJA E INFORMACIONIT

Neni 24
Përdorimi i informacionit

1. Pa paragjykuar nenin 36, çdo informacion i komunikuar sipas kësaj Konvente do të përdoret vetëm nga administrata doganore për të cilën është dërguar dhe vetëm për qëllime të ndihmës së ndërsjellë sipas kushteve të vendosura në këtë Konventë.

2. Sipas kërkesës, Pala Kontraktuese që ka dërguar informacionin, pa paragjykuar paragrafin 1 të këtij neni, mund të autorizojë përdorimin e tij për qëllime të tjera ose nga autoritete të tjera, kushtëzuar nga termat dhe kushtet që mund të caktojë. Ky përdorim do të jetë në përputhje me dispozitat ligjore dhe administrative të Palës Kontraktuese që kërkon të përdorë këtë informacion. Përdorimi i informacionit për qëllime të tjera përfshin përdorimin në hetime kriminale, procedime apo penalizime.

Neni 25
Konfidencialiteti dhe mbrojtja e informacionit

1. Çdo informacion i komunikuar sipas kësaj Konvente do të trajtohet si konfidencial dhe, të paktën, do të gëzojë të njëjtën mbrojtje dhe konfidencialitet siç gëzon i njëjti informacion nën dispozitat ligjore dhe administrative të Palës Kontraktuese që e ka marrë.

2. Shkëmbimi i të dhënave ndërmjet dy ose më shumë Palëve Kontraktuese sipas kësaj Konvente nuk do të fillojë derisa Palët Kontraktuese në fjalë, sipas rregullimeve në përputhje me paragrafin 2 të nenit 48, të kenë vendosur se këto të dhëna do të gëzojnë në territorin e Palës Kontraktuese marrëse, një nivel mbrojtjeje të tillë që plotëson kërkesat e ligjit kombëtar të Palës Kontraktuese dërguese.

3. Në mungesë të rregullimeve të ndërsjella siç referohen në paragrafin 2 të këtij neni, të dhënat personale mund të dërgohen kur Pala Kontraktuese dërguese është e kënaqur se këto të dhëna personale do të mbrohen në territorin e Palës Kontraktuese marrëse në përputhje me dispozitat e kësaj Konvente.

4. Palët Kontraktuese, në momentin e firmosjes, ratifikimit apo hyrjes në këtë Konventë, do të njoftojnë Sekretarin e Përgjithshëm me shkrim mbi dispozitat e tyre ligjore apo administrative në

respekt të konfidencialitetit të informacionit dhe mbrojtjes së të dhënave personale. Ato do të bëjnë një deklaratë me shkrim te Sekretari i Përgjithshëm në kohën e firmosjes, ratifikimit apo hyrjes, mbi detyrimet e tyre, të paktën mbi detyrimin e konfidencialitetit të informacionit dhe dispozitave të mbrojtjes së të dhënave të kësaj Konvente.

Neni 26

Mbrojtja e të dhënave personale

1. Të dhënat personale do t'i transmetohen vetëm një administrate doganore. Dërgimi i të dhënave personale te një autoritet tjetër do të lejohet vetëm pas një aprovimi paraprak nga administrata doganore e cila ka dërguar të dhënat në fjalë.

2. Sipas kërkesës, administrata doganore e cila ka marrë të dhëna personale, do të informojë administratën doganore që ka dërguar të dhënat mbi përdorimin që i është bërë të dhënave dhe mbi rezultatet e arritura.

3. Të dhënat personale të dërguara sipas kësaj Konvente do të mbahen vetëm për kohën e nevojshme për të arritur qëllimet për të cilat është dërguar.

4. Administrata doganore e cila dërgon të dhëna personale, për aq sa ka mundësi, do të sigurojë se këto të dhëna janë grumbulluar saktësisht dhe ligjërisht dhe se janë të plota dhe të rishikuara dhe nuk e tejkalojnë qëllimin për të cilin janë dërguar.

5. Nëse të dhënat personale të dërguara duket se janë jokorrekte ose nuk duhet të ishin shkëmbyer, kjo gjë duhet njoftuar menjëherë. Administrata doganore e cila ka marrë këto të dhëna duhet t'i ndryshojë ose t'i fshijë.

6. Administratat doganore do të regjistrojnë dërgimin ose marrjen e të dhënave personale të shkëmbyera sipas kësaj Konvente.

7. Administratat doganore do të ndërmarrin masat e nevojshme të sigurisë për të mbrojtur të dhënat personale të shkëmbyera sipas kësaj Konvente nga akseset e paautorizuara, ndryshimi apo shpërndarjet.

8. Një Palë Kontraktuese do të jetë përgjegjëse, në përputhje me dispozitat e veta ligjore dhe administrative, për dëmtimin shkaktuar një personi nga përdorimi i të dhënave personale të shkëmbyera sipas kësaj Konvente. Gjithashtu, ky do të jetë dhe rasti kur dëmtimi është shkaktuar nga një Palë Kontraktuese që ka dërguar të dhëna jo të sakta ose që ka dërguar të dhëna të cilat janë në kundërshtim me këtë Konventë.

9. Nëse një Palë Kontraktuese e gjetur përgjegjëse për dëmtime sipas paragrafit 8 të këtij neni nuk është Pala Kontraktuese e cila ka dërguar të dhëna personale, Palët Kontraktuese të interesuara do të rakordojnë mbi termat dhe kushtet e rimbursimit te Pala Kontraktuese përgjegjëse mbi shumat që kjo palë ka paguar si kompensim.

KAPITULLI VIII

PËRQENDRIMI I INFORMACIONIT

Neni 27

Qëllimi i përqendrimit

1. Informacioni i referuar në nenet 28, 29 dhe 30 do të vendoset në një sistem të automatizuar qendror informacioni të sigurtë për qëllimet e përcaktimit të riskut e për të siguruar zbatimin e saktë të ligjit doganor për parandalimin, hetimin dhe luftën ndaj shkeljeve doganore dhe për të garantuar sigurinë e rrjetit ndërkombëtar të furnizimit të tregtisë.

2. Të dhënat personale do të vendosen gjithashtu në një sistem qendror informacioni të automatizuar për qëllimet e dhënies së informacionit mbi persona të njohur se kanë kryer një shkelje doganore ose të dyshuar se janë gati të kryejnë një shkelje doganore.

Neni 28

Informacioni jopersonal

1. Për qëllimet e neneve 27 dhe 31 dhe nëse është e lejueshme sipas ligjeve të tyre kombëtare, administratat doganore do të dërgojnë te sistemi qendror i automatizuar i informacionit informacionet

e mëposhtme jopersonale:

- i) informacion mbi çështjen në referencë, kur është e nevojshme;
 - ii) mallrat;
 - iii) sasi të dhe njësitë e matjes;
 - iv) mjetet e transportit;
 - v) mënyrat e fshehjes;
 - vi) tregues nëse mallrat janë gjetur gjatë importit, eksportit, në transit apo në brendësi të territorit;
 - vii) rrugën;
 - viii) mjetet e gjetjes.
2. Komiteti Administrativ do të ketë autoritetin për të modifikuar listën e paragrafit 1 të këtij neni.

Neni 29

Informacion mbi persona fizikë dhe juridikë

1. Për qëllimet e neneve 27 dhe 31 dhe nëse është e lejueshme nga ligjet e tyre kombëtare, administratat doganore mund t'i komunikojnë sistemit qendror të automatizuar të informacionit, informacionin e mëposhtëm:

A. Mbi personat fizikë:

- i) mbiemrin, emrin e dhënë, emrin dhe pseudonimet, dhe emrat e kaluar sipas rastit;
- ii) datën dhe vendin e lindjes;
- iii) kombësinë;
- iv) llojin dhe numrin e dokumenteve të identifikimit;
- v) seksin;
- vi) vendin e banimit;
- vii) natyrën e shkeljes;
- viii) punësimin;
- ix) tiparet e dallueshme;
- x) historinë e mëparshme ose informacione mbi dyshime;
- xi) numrat e regjistrimit të mjeteve të transportit;
- xii) tregues të nivelit të rrezikut që mund të mbartë personi;
- xiii) arsye specifike për përfshirjen e të dhënave;
- xiv) organizatën kriminale së cilës i takon;
- xv) bashkëpunëtorë të njohur.

B. Mbi personat juridikë:

- i) emrin, emrin tregtar;
- ii) vendin e regjistrimit;
- iii) numrin e regjistrimit;
- iv) datën e regjistrimit;
- v) zyrën e regjistrimit;
- vi) adresën tregtare;
- vii) llojin e biznesit;
- viii) llojin e shkeljes;
- ix) historitë e kaluara ose informacione mbi personat e dyshuar juridikë;
- x) arsye specifike për përfshirjen e të dhënave;
- xi) emrat e drejtuesve ose punonjësve dhe nëse është e mundur çdo informacion tjetër identifikues siç përshkruhet në paragrafin (A) i deri xv.

2. Komiteti Administrativ do të ketë autoritetin të modifikojë listat në paragrafët 1(A) dhe (B) të këtij neni.

Neni 30

Informacione të tjera

Administratat doganore mund t'i komunikojnë sistemit qendror të automatizuar të

informacionit, nëse është e lejueshme sipas ligjeve të tyre kombëtare, çdo lloj informacioni që mund të ketë lidhje me zbatimin e duhur të ligjit doganor për parandalimin, hetimin dhe luftën ndaj shkeljeve doganore, dhe për të garantuar sigurinë e rrjetit ndërkombëtar të furnizimit të tregtisë.

Neni 31

Sistemi qendror i automatizuar i informacionit

1. Informacioni i përmendur në nenet 28, 29 dhe 30 do të vendoset në një sistem të sigurtë qendror të automatizuar informacioni për qëllime doganore. Ky sistem do të menaxhohet nga drejtoria e këshillit dhe do të lejojë hyrje sipas dispozitave të caktuara në nenin 38.

2. Komunikimi i informacionit nga një Palë Kontraktuese drejt sistemit qendror të automatizuar të informacionit do të kushtëzohet nga dispozitat administrative dhe ligjore të asaj Pale, me përjashtim të rasteve kur Konventa përcakton dispozita më strikte.

3. Çdo Palë Kontraktuese do të caktojë një autoritet kompetent në administratën e vet doganore për të qenë kompetent në nivel kombëtar për zbatimin korrekt të sistemit qendror të automatizuar të informacionit dhe për masat e nevojshme për të siguruar zbatueshmërinë e kapitujve VIII dhe X.

4. Sekretari i Përgjithshëm do të caktojë punonjësit e Këshillit për të qenë përgjegjës në nivelin e Këshillit për zbatimin korrekt dhe mirëmbajtjen e sistemit qendror të automatizuar të informacionit dhe për masat e nevojshme për të siguruar zbatueshmërinë e neneve VIII dhe X.

5. Çdo Palë Kontraktuese do të njoftojë Sekretarin e Përgjithshëm mbi autoritetet kompetente që ka caktuar sipas paragrafit 3 të këtij neni, i cili do të mundësojë këtë informacion te Palët e tjera Kontraktuese, së bashku me ndonjë informacion lidhur me punonjësit e Këshillit, të caktuar sipas paragrafit 4 të këtij neni. Informacioni i referuar në këtë paragraf do të përfshihet në sistemin qendror të automatizuar të informacionit, por nuk do të kushtëzohet nga dispozitat e kapitullit VII.

Neni 32

Menaxhimi i sistemit qendror të automatizuar të informacionit

1. Një skuadër do të ngrihet për të menaxhuar sistemin qendror të automatizuar të informacionit lidhur me çështjet teknike, operacionale dhe procedurale. Ajo do të përbëhet nga përfaqesues të administratave doganore të Palëve Kontraktuese dhe punonjës të Këshillit. Përbërja e skuadrës menaxhuese do të vendoset nga Komiteti Administrativ.

2. Ekipet menaxhuese do të përcaktojnë procedurat për të gjitha çështjet teknike dhe operacionale lidhur me:

a) komunikimin e informacionit, në përputhje me nenet 28, 29 dhe 30;

b) aksesin në sistemin qendror të automatizuar të informacionit dhe në informacionet që ai përmban, në përputhje me nenin 38 dhe

c) ndryshimin e informacionit, në përputhje me dispozitat e neneve 39 dhe 40.

3. Pas marrjes së aprovimit nga Komiteti Administrativ për procedurat e referuara në paragrafin 2 të këtij neni, ekipet manaxhuese do të sigurojnë zbatimin.

4. Ekipet manaxhuese do të raportojnë të paktën një herë në vit tek Komiteti Administrativ mbi menaxhimin e sistemit qendror të automatizuar të informacionit sipas paragrafit 1, 2 dhe 3 të këtij neni, duke bërë rekomandimet e nevojshme.

KAPITULLI IX

SIGURIMI I SISTEMIT QENDROR TË AUTOMATIZUAR TË INFORMACIONIT

Neni 33

Përgjegjësia për masat e sigurisë

1. Palët Kontraktuese dhe Sekretari i Përgjithshëm do të jenë përgjegjës për zbatimin e të gjitha masave të nevojshme për sigurinë e sistemit qendror të automatizuar të informacionit. Objektivat e këtyre masave do të përfshijnë, por nuk do të kufizohen në:

a) parandalimin e aksesit të paautorizuar te pajisjet e përdorura për përpunimin e të dhënave

në sistem;

b) parandalimin e aksesit të paautorizuar në sistem;

c) parandalimin e hyrjes, leximit, kopjimit, amendimit apo fshirjes së paautorizuar të çdo informacioni në sistem;

d) sigurimin se është i mundur kontrolli dhe përcaktimi se cili autoritet kompetent i caktuar dhe zyrtarë të Këshillit, referuar në paragrafin 1 të nenit 38, kanë akses në sistemin qendror të automatizuar të informacionit dhe cilët punonjës dhe zyrtarë të caktuar të Këshillit, referuar në paragrafin 2 të nenit 38, kanë akses për informacionin në sistem;

e) sigurimin se është i mundur kontrolli dhe përcaktimi se cili informacion ka hyrë në sistem, nga kush dhe të monitorojnë kërkimet;

f) parandalimin e leximit, kopjimit, ndryshimeve apo fshirjes së paautorizuar të informacionit gjatë komunikimit të të dhënave dhe transportimit të të dhënave.

2. Përfaqësuesi apo përfaqësuesit e pavarur të caktuar sipas paragrafit 1(f) të nenit 45 do të kryejnë verifikime të aksesit dhe të kërtimeve mbi të dhënat personale për të siguruar se aksesit dhe kërkimet e bëra janë të pranueshme dhe janë kryer nga përdorues të autorizuar. Një regjistër i të gjitha verifikimeve do të mbahet në sistem për të raportuar te Komiteti Administrativ dhe që do të fshihet pas 12 muajsh.

Neni 34

Zbatimi i masave të sigurisë

1. Çdo Palë Kontraktuese do të caktojë një autoritet kompetent në administratën e vet doganore për të zbatuar, në nivel kombëtar, masat e sigurisë të referuara në paragrafin 1 të nenit 33.

2. Sekretari i Përgjithshëm do të caktojë punonjësit e Këshillit për të zbatuar, në nivel këshilli, masat e sigurisë të referuara në paragrafin 1 të nenit 33.

3. Çdo Palë Kontraktuese do të njoftojë Sekretarin e Përgjithshëm mbi autoritetet kompetente që ka caktuar sipas paragrafit 1 të këtij neni, të cilët do të mundësojnë këtë informacion te Palët e tjera Kontraktuese, së bashku me çdo informacion tjetër lidhur me punonjësit e Këshillit të caktuar sipas paragrafit 2 të këtij neni. Informacioni i përmendur në këtë paragraf do të përfshihet në sistemin qendror të automatizuar të informacionit, por nuk do të kushtëzohet nga dispozitat e kapitullit VII.

KAPITULLI X

MBROJTJA E INFORMACIONIT NË SISTEMIN QENDROR TË AUTOMATIZUAR TË INFORMACIONIT

Neni 35

Përfshirja e informacionit

Përfshirja e informacionit në sistemin qendror të automatizuar të informacionit do të udhëhiqet nga dispozitat ligjore dhe administrative të Palës Kontraktuese dërguese, me përjashtim të rasteve kur kjo Konventë parashtron dispozita më strikte.

Neni 36

Përdorimi i informacionit

1. Përdorimi i informacionit të marë nga sistemi qendror i automatizuar i informacionit do të udhëhiqet nga dispozitat ligjore dhe administrative të Palës Kontraktuese që përdor këtë informacion, me përjashtim të rasteve kur Konventa parashtron dispozita më strikte.

2. Palët Kontraktuese mund të përdorin vetëm informacionin e përfituar nga sistemi qendror i automatizuar i informacionit me synim arritjen e qëllimeve të përmendura në nenin 27. Gjithsesi, sipas kërkesës, Pala Kontraktuese që ka dërguar informacionin mund të autorizojë përdorimin e tij për qëllime të tjera, kushtëzuar nga termat dhe konditat që ajo mund të specifikojë. Ky përdorim tjetër duhet të jetë në përputhje me dispozitat ligjore dhe administrative të Palës Kontraktuese që kërkon të përdorë këtë informacion. Përdorimi i informacionit për qëllime të tjera përfshin përdorimin e tij në hetime kriminale, procese ose gjykatë.

3. Nën përgjegjësinë e Sekretarit të Përgjithshëm, punonjësit e Këshillit mund të përdorin informacionin e përftuar nga sistemi qendror i automatizuar i informacionit vetëm për të kryer detyrat e kërkuara nga kjo Konventë, sipas kushteve që mund të vendosë Komiteti Administrativ.

4. Të dhënat personale mund të përdoren vetëm kur përftohen nga sistemi qendror i automatizuar i informacionit në përputhje me paragrafin 7 të nenit 38.

Neni 37

Mbajtja e të dhënave personale

1. Të dhënat personale të përfshira në sistemin qendror të automatizuar të informacionit do të mbahen vetëm për kohën e nevojshme për të arritur qëllimin për të cilin janë dërguar. Palët Kontraktuese do të specifikojnë periudhën e mbajtjes në sistem të të dhënave personale që ato dërgojnë.

2. Një Palë Kontraktuese dërguese mund të zgjasë periudhën e mbajtjes referuar në paragrafin 1 të këtij neni nëse mbajtja e të dhënave personale është e nevojshme për qëllimet për të cilat është dërguar. Nëse nuk ka zgjatje të kësaj periudhe, të dhënat do të fshihen nga sistemi qendror i automatizuar i informacionit me iniciativë të Palës Kontraktuese që ka dërguar të dhënat personale.

3. Sekretari i Përgjithshëm do të informojë Palën Kontraktuese dërguese mbi fshirjen e menjëhershme të të dhënave personale sipas paragrafit 2 të këtij neni, duke dhënë njoftim njëmuajor.

4. Përfaqësuesi apo përfaqësuesit e pavarur të caktuar sipas paragrafit 1(f) të nenit 45 do të kryejnë verifikime për të siguruar se periudha e mbajtjes së të dhënave personale në sistemin qendror të automatizuar të informacionit është respektuar. Një regjistrim i të gjitha verifikimeve do të mirëmbahet në sistem për t'u raportuar te Komiteti Administrativ dhe që do të fshihet pas 12 muajsh.

Neni 38

Aksesi

1. Autoritetet kompetente dhe punonjësit e Këshillit të caktuar në përputhje me paragrafët 3 dhe 4 të nenit 31, do të kenë akses (hyrje) në sistemin qendror të automatizuar të informacionit.

2. Për qëllimet e nenit 27 dhe pa paragjykuar paragrafin 7 të këtij neni, Palët Kontraktuese do të caktojnë punonjës në administratat e tyre doganore, dhe Sekretari i Përgjithshëm do të caktojë punonjësit e Këshillit, të cilët do të kenë akses në informacionin e sistemit qendror të automatizuar të informacionit.

3. Aksesi në sistem do të jetë në përputhje me procedurat e referuara në paragrafin 2 të nenit 32. Për qëllimet e zbatimit të nenit 32, ekupe manaxhuese do të kenë akses në sistemin qendror të automatizuar të informacionit.

4. Komiteti Administrativ do të lejojë akses tek informacioni jopersonal në sistemin qendror të automatizuar të informacionit për organizmat ndërkombëtarë rajonalë dhe qeveritarë mbi bazën e reciprocitetit dhe të kushteve që mund të specifikojë Komiteti Administrativ.

5. Përfaqësuesi apo përfaqësuesit e caktuar nga Komiteti Administrativ sipas paragrafit 1(f) të nenit 45 do të kenë akses te sistemi qendror i automatizuar i informacionit.

6. Çdo Palë Kontraktuese do të njoftojë Sekretarin e Përgjithshëm mbi punonjësit që ka caktuar sipas paragrafit 2 të këtij neni. Sekretari i Përgjithshëm do t'ua mundësojë këtë informacion Palëve Kontraktuese, së bashku me informacionet lidhur me punonjësit e Këshillit të caktuar sipas të njëjtit paragraf. Informacioni i përmendur në këtë paragraf do të përfshihet në sistemin qendror të automatizuar të informacionit, por nuk do të kushtëzohet nga dispozitat e kapitullit VII.

7. Palët Kontraktuese mund të përcaktojnë se kush do të ketë apo nuk do të ketë akses te të dhënat personale që ato dërgojnë.

8. Të drejtat e personave fizikë lidhur me të dhënat personale në sistemin qendror të automatizuar të informacionit, në veçanti ato lidhur me aksesin, do të kenë efekt në përputhje me dispozitat ligjore dhe administrative të Palës Kontraktuese në territorin e së cilës këto të drejta lindin.

Neni 39

Ndryshimi i informacionit jopersonal në sistemin qendror të automatizuar të informacionit

1. Të dhënat jopersonale në sistemin qendror të automatizuar të informacionit do të ndryshojnë, shtohen, korrektohen apo fshihen vetëm me iniciativë të Palës Kontraktuese dërguese.

2. Të dhënat jopersonale do të amendohen, shtohen, korrektohen apo fshihen në përputhje me procedurat e përcaktuara dhe zbatuara nga ekiye manaxhuese sipas paragrafëve 2 dhe 3 të nenit 32.

Neni 40

Ndryshimi i të dhënave personale në sistemin qendror të automatizuar të informacionit

1. Të dhënat personale në sistemin qendror të automatizuar të informacionit do të amendohen, shtohen, korrektohen apo fshihen vetëm me iniciativë të Palës Kontraktuese dërguese.

2. Nëse një Palë Kontraktuese shikon se të dhënat personale që ka dërguar janë të pasakta ose janë përfshirë apo magazinuar në sistemin qendror të automatizuar të informacionit në kundërshtim me këtë Konventë, ajo do të rregullojë mbi amendimin, shtimin, korrigjimin ose fshirjen e të dhënave pa vonesë. Palët Kontraktuese të interesuara do të bien dakord me Sekretarin e Përgjithshëm për të njoftuar ata të cilët kanë akses në të dhënat personale, siç referohet në paragrafin 7 të nenit 38, mbi këto amendime, shtesa, korrigjime apo fshirje.

3. Nëse një Palë Kontraktuese ka informacion për të sugjeruar se ndonjë e dhënë personale është e pasaktë ose ishte përfshirë, ose ruajtur në sistemin qendror të automatizuar të informacionit në kundërshtim me këtë Konventë, ajo do të njoftojë Palën Kontraktuese dërguese sa më shpejt të jetë e mundur. Kjo e fundit do të kontrollojë të dhënat në fjalë dhe nëse është e nevojshme do të rakordojë mbi ndryshimet, shtimet, korrigjimet apo fshirjet pa vonesë. Pala Kontraktuese dërguese do të rakordojë me Sekretarin e Përgjithshëm për të njoftuar ata që kanë akses në të dhënat personale, siç referohet në paragrafin 7 të nenit 38, mbi këto amendime, shtime, korrekte apo fshirje.

4. Nëse, në momentin e përfshirjes së të dhënave personale në sistemin qendror të automatizuar të informacionit, një Palë Kontraktuese kupton se të dhënat e veta personale bien në konflikt me të dhënat personale të dërguara nga një Palë tjetër Kontraktuese, kjo do të këshillojë menjëherë Palën Kontraktuese që ka dërguar këto të dhëna. Palët Kontraktuese të interesuara do të përpiqen të zgjidhin çështjen. Nëse zgjidhja e çështjes rezulton në një ndryshim, shtim, korrigjim apo fshirje të të dhënave personale, Pala Kontraktuese që ka dërguar të dhënat do të rakordojë me Sekretarin e Përgjithshëm për të njoftuar ata që kanë akses në të dhënat personale, siç referohet në paragrafin 7 të nenit 38, mbi këto ndryshime, shtime, korrigjime apo fshirje.

5. Kur një gjykatë apo autoritet tjetër kompetent brenda territorit të një Palë Kontraktuese merr një vendim final lidhur me ndryshimin, shtimin, korrigjimin apo fshirjen e të dhënave personale në sistemin qendror të automatizuar të informacionit, Pala Kontraktuese në territorin e së cilës u mor vendimi, do të rakordojë, nëse është ajo që ka dërguar të dhënat mbi ndryshimet, shtesat, korrigjimet apo fshirjen e këtyre të dhënave pa vonesë ose nëse të dhënat janë dërguar nga një Palë tjetër Kontraktuese, ajo do të këshillojë Palën Kontraktuese dërguese mbi këtë vendim. Pala Kontraktuese dërguese do të rakordojë atëherë për ndryshimin, shtesat, korrektimin apo fshirjen e të dhënave pa vonesë.

Neni 41

Përgjegjësitë dhe detyrimet

1. Një Palë Kontraktuese do të jetë përgjegjëse, për aq sa është e mundur, për saktësinë dhe ligjshmërinë e informacionit që ka përfshirë në sistemin qendror të automatizuar të informacionit.

2. Një Palë Kontraktuese do të mbajë përgjegjësi, në përputhje me dispozitat e veta ligjore dhe administrative, për dëmtimet shkaktuar një personi nga përdorimi i informacionit të përftuar nga sistemi qendror i automatizuar i informacionit nga kjo Palë Kontraktuese. I njëjtë do të jetë rasti kur dëmtimi është shkaktuar nga Pala Kontraktuese dërguese, e cila ka futur të dhëna të pasakta ose ka futur të dhëna në kundërshtim me këtë Konventë.

3. Nëse Pala Kontraktuese e gjetur përgjegjëse për dëmtime, sipas paragrafit 2 të këtij neni, nuk është Pala Kontraktuese e cila ka dërguar këtë informacion, Palët Kontraktuese të interesuara do të rakordojnë mbi termat dhe kushtet e rimbursimit të Palës Kontraktuese përgjegjëse mbi shumat që ka paguar si kompensim.

4. Një Palë Kontraktuese do të jetë përgjegjëse, në përputhje me dispozitat e veta ligjore dhe administrative, për dëmtimet e shkaktuara ndaj një personi nëpërmjet përdorimit të informacionit nga punonjësit e Këshillit të përfutur nga sistemi qendror i automatizuar i informacionit, në kundërshtim me këtë Konventë, për faktin se ky informacion është përfshirë në sistem nga kjo Palë Kontraktuese.

5. Nëse dëmi është përcaktuar nga një autoritet kompetent ligjor në respekt të paragrafit 4 të këtij neni, Pala Kontraktuese e referuar mund t'ia transmetojë vendimin Komitetit Administrativ i cili do t'i bëjë një rekomandim Këshillit lidhur me ndonjë rimbursim.

KAPITULLI XI PËRJASHTIME DHE REZERVA

Neni 42 Përrjashtime

1. Kur një ndihmë e kërkuar sipas kësaj Konvente mund të shkelë sovranitetin, ligjet dhe detyrimet sipas traktateve, sigurinë, politikat publike ose çdo interes tjetër thelbësor kombëtar të një Pale Kontraktuese të kërkuar ose mund të paragjykojë interesa të ligjshme komerciale apo profesionale, një ndihmë e tillë mund të refuzohet nga kjo Palë Kontraktuese ose mund të jepet në bazë të termave dhe kushteve që ajo mund të vendosë.

2. Kur një administratë kërkuuese e ka të pamundur t'i përgjigjë një kërkesë të ngjashme që mund të bëhet nga administrata e kërkuar, ajo do ta theksojë këtë fakt në kërkesë. Përgjigja ndaj një kërkesë të tillë do të varet nga administrata e kërkuar.

3. Ndiham mund të shtyhet nëse ka baza për të besuar se ajo mund të ndërhyjë në një hetim në vazhdim apo procedim. Në një rast të tillë, administrata e kërkuar do të konsultohet me administratën kërkuuese për të përcaktuar nëse ndihma mund të jepet bazuar në termat dhe kushtet që mund të specifikojë administrata e kërkuar.

4. Nëse administrata e kërkuar konsideron se përpjekja e kërkuar për të përmbushur një kërkesë është qartësisht në disproporcion me përfitimin e parashikuar të administratës kërkuuese, ajo mund të kundërshtojë dhënien e ndihmës.

5. Kur ndihma mohohet apo shtyhet, duhet të paraqiten shkaqet për mohimin apo shtyrjen.

Neni 43 Rezerva

1. Nenet 9, 10, 12, 14, 15, 16 17, 19, 20, 21, 22, 23, 29 dhe 30 mundet, pjesërisht apo tërësisht, të kushtëzohen nga rezerva.

2. Një Palë Kontraktuese do të konsiderohet se i ka pranuar të gjitha dispozitat e neneve 9, 10, 12, 14, 15, 16, 17, 19, 20, 21, 22, 23, 29 dhe 30 nëse në momentin e firmosjes, ratifikimit apo hyrjes në Konventë nuk e ka njoftuar Sekretarin e Përgjithshëm mbi ndonjë rezervim lidhur me këto dispozita.

3. Një Palë Kontraktuese që ka pasur rezerva mund t'i tërheqë ato, pjesërisht apo tërësisht, në çdo moment nëpërmjet njoftimit te depozituesi ku specifikon datën në të cilat marrin efekt këto anulime.

KAPITULLI XII KOSTOT

Neni 44

1. Kushtëzuar nga paragrafët 2 dhe 3 të këtij neni, kostot e dala nga zbatimi i kësaj Konvente do të mbulohen nga Pala Kontraktuese e kërkuar.

2. Shpenzimet dhe dietat paguar ekspertëve dhe dëshmitarëve, si dhe kostot e përkthyesve dhe interpretuesve që nuk janë punonjës qeveritarë, do të mbulohen nga Pala Kontraktuese kërkuuese.

3. Nëse ekzekutimi i një kërkesë kërkon shpenzime të një natyre thelbësore apo të jashtëzakonshme, Palët Kontraktuese do të konsultohen për të përcaktuar termat dhe kushtet sipas të cilave do të ekzekutohet kërkesa, si dhe mënyrën me të cilën do të përballohen kostot.

KAPITULLI XIII DISPOZITA PËRFUNDIMTARE

Neni 45

Menaxhimi i Konventës

1. Një Komitet Administrativ do të ngrihet:

a) për të marrë në konsideratë çështje lidhur me zbatimin dhe administrimin e kësaj Konvente, si dhe mbi ndryshimet e propozuara;

b) për t'u rekomanduar Palëve Kontraktuese ndryshimin e kësaj Konvente;

c) për t'u rekomanduar Palëve Kontraktuese masat për të siguruar interpretimin uniform dhe zbatimin e kësaj Konvente;

d) për të vendosur mbi përbërjen e skuadrës manaxhuese referuar në paragrafin 1 të nenit 32;

e) për të ekzaminuar dhe aprovuar procedurat teknike dhe operacionale referuar në paragrafin 2 të nenit 32 lidhur me sistemin qendror të automatizuar të informacionit;

f) për të caktuar një ose më tepër përfaqësues të pavarur për të kryer verifikimet e referuara në paragrafin 2 të nenit 33 dhe paragrafin 4 të nenit 37 dhe për të përcaktuar fushëmbulimin, frekuencën dhe termat e kushtet e tjera për të tilla verifikime;

g) për të determinuar kushtet e referuara në paragrafin 3 të nenit 36 lidhur me përdorimin nga punonjësit e këshillit të informacionit të përfutur nëpërmjet sistemit qendror të automatizuar të informacionit;

h) për të përcaktuar kushtet e referuara në paragrafin 4 të nenit 38 lidhur me lejimin e aksesit për informacionin jopersonal në sistemin qendror të automatizuar të informacionit për organizatat ndërkombëtare dhe qeveritare rajonale;

i) për të bërë rekomandime të Këshilli lidhur me rimbursimet sipas paragrafit 5 të nenit 41;

j) për të mirëmbajtur lidhjet me organizata të tjera ndërkombëtare të interesuara;

k) për të konsideruar çështje të tjera lidhur me këtë Konventë që mund t'i referohen kësaj;

l) për të informuar Komitetin e Antikontrabandës dhe Këshillin mbi vendimet e mara.

2. Komiteti Administrativ do të marrë vendime lidhur me ndryshimin e listës në nenet 10, 28 dhe 29, sipas kërkesës, pa kundërshtuar nenin 49 dhe lidhur me zbatimin e këtyre vendimeve.

3. Të gjitha Palët Kontraktuese në këtë Konventë do të jenë anëtarë të Komitetit Administrativ;

4. Çdo entitet i kualifikuar për të qenë një Palë Kontraktuese në këtë Konventë sipas dispozitave të nenit 46 mund të ftohet të ndjekë sesionet e Komitetit Administrativ si vëzhgues. Statusi dhe të drejtat e këtyre vëzhguesve do të përcaktohen nga Komiteti Administrativ. Komiteti Administrativ mund të ftojë përfaqësues të organizatave ndërkombëtare për të ndjekur sesionet e veta si vëzhgues.

5. Komiteti Administrativ do të përcaktojë rregullat e procedurave të veta nga shumica e jo më pak se dy të tretave të Palëve Kontraktuese në këtë Konventë. Në mungesë të rregullave të procedurave të Komitetit Administrativ në kohën e hyrjes në fuqi të kësaj Konvente, rregullat e procedurës së Këshillit do të zbatohen derisa Komiteti Administrativ të adoptojë rregullat e veta.

6. Pa paragjykuar paragrafin 5 të këtij neni, çështjet e lidhura me këtë Konventë përpara Komitetit Administrativ do të të vendosen me konsensusin e atyre prezente. Kur nuk mund të arrihet një vendim me konsensus, çështja do të vendoset nga shumica e thjeshtë e votave e atyre prezente. Në çdo rast, për qëllimet e ndryshimit të listës në paragrafin 2 të nenit 10, paragrafit 1 të nenit 28, paragrafit 1 të nenit 29, si dhe për qëllimet e caktimit të një ose më shumë përfaqësuesve nën paragrafin 1(f) të këtij neni, vendimet do të merren nga maxhoranca e jo më pak se dy të tretave të Palëve Kontraktuese prezente dhe me të drejtë vote. Në rastin e lejimit të aksesit për informacionin jopersonal referuar në paragrafin 4 të nenit 38, vendimi do të merret nga vota unanime e atyre

prezente.

7. Secila Palë Kontraktuese do të ketë të drejtën e një vote. Kur zbatohen paragrafët 3 dhe 4 të nenit 46, unionet doganore apo ekonomike të cilat janë Palë Kontraktuese do të kenë, në rast votimi, vetëm një numër votash të barabartë me totalin e votave të alokuara për anëtarët e tyre që janë Palë Kontraktuese.

8. Komiteti Administrativ do të mbledhet të paktën një herë në çdo vit. Do të zgjedhë për çdo vit një kryetar dhe një nënkryetar. Administratat Doganore të Palëve Kontraktuese do t'i komunikojnë Sekretarit të Përgjithshëm çdo kërkesë për përfshirjen në axhentën e sesioneve të Komitetit Administrativ. Sekretari i Përgjithshëm do të shpërndajë ftesën dhe draftaxhentën tek administratat doganore të Palëve Kontraktuese dhe te vëzhguesit e referuar në paragrafin 4 të këtij neni të paktën gjashtë javë përpara mbledhjes së Komitetit Administrativ.

9. Këshilli do t'i mundësojë Komitetit Administrativ shërbime sekretarie.

Neni 46

Firmosja, ratifikimi dhe pranimi

1. Çdo anëtar i Këshillit dhe çdo anëtar i Kombeve të Bashkuara ose agjencitë e veta të specializuara mund të bëhen anëtarë kontraktuese në këtë Konventë:

- duke e firmosur atë pa rezerva ratifikimi;
- duke depozituar një instrument ratifikimi pas firmosjes kushtëzuar ratifikimit ose
- duke hyrë në të.

2. Kjo Konventë do të jetë e hapur deri më 28 qershor 2004 për firmosje në zyrat e Këshillit në Bruksel nga anëtarët e referuar në paragrafin 1 të këtij neni. Pas kësaj do të jetë e hapur për pranim për këta anëtarë.

3. Çdo union ekonomik apo doganor mund të bëhet Palë Kontraktuese në këtë Konventë në përputhje me paragrafët 1 dhe 2 të këtij neni. Këto unione ekonomike apo doganore do të informojnë Sekretarin e Përgjithshëm mbi anëtarët që përbëjnë Unionin, si dhe mbi kompetencat e veta në respekt të çështjeve të trajtuara nga kjo Konventë. Këto unione ekonomike apo doganore do të njoftojnë gjithashtu Sekretarin e Përgjithshëm mbi çdo modifikim thelbësor në përfshirje të këtyre kompetencave.

4. Një union ekonomik apo doganor që është Palë Kontraktuese në këtë Konventë, për çështjet brenda kompetencave të veta, do të ushtrojë nën emrin e vet të drejtat, dhe përmbushë përgjegjësitë të cilat Konventa ofron për anëtarët e një unioni të tillë të cilët janë Palë Kontraktuese në këtë Konventë. Në rast të tillë, anëtarët e një unioni të tillë nuk do të kenë të drejtë të ushtrojnë individualisht këto të drejta, duke përfshirë të drejtën për të votuar.

5. Secila Palë Kontraktuese që ratifikon këtë Konventë ose e pranon atë do të kushtëzohet nga çdo amendim i kësaj Konvente që ka hyrë në fuqi në datën e depozitimit të instrumenteve të veta të ratifikimit apo hyrjes.

Neni 47

Zbatimi territorial i Konventës

1. Secila Palë Kontraktuese mund të deklarojë në çdo kohë nëpërmjet një njoftimi të dhënë te depozitari se kjo Konventë do të zbatohet në të gjithë apo në secilin nga territoret për të cilat është përgjegjëse për marrëdhëniet ndërkombëtare. Këto njoftime do të kenë efekt tre muaj pas datës së marrjes së njoftimit në fjalë nga depozitari. Gjithsesi, kjo Konventë nuk do të zbatohet në ndonjë nga territoret e emëruara në njoftim përpara se kjo Konventë të ketë hyrë në fuqi për Palën Kontraktuese në fjalë.

2. Secila Palë Kontraktuese që ka bërë njoftimin sipas paragrafit 1 të këtij neni, për ta zbatuar këtë Konventë në çdo territor për marrëdhëniet ndërkombëtare të së cilit është përgjegjës mund të njoftojë te depozitari, sipas procedurave të nenit 52 të kësaj Konvente, se territori në fjalë nuk do ta zbatojë më këtë Konventë.

Neni 48

Implementimi dhe aplikimi i Konventës

1. Në zbatim të kësaj Konvente, Palët Kontraktuese do të ndërmarrin masat e nevojshme për të siguruar, aq sa është e mundur, se punonjësit e vet që janë përgjegjës për hetimin apo luftën ndaj shkeljeve doganore do të mbajnë lidhje personale dhe direkte me njëri-tjetrin.

2. Dy ose më tepër Palë Kontraktuese mund të vendosin mbi rregullimet e ndërsjella për të lehtësuar implementimin dhe aplikimin e kësaj Konvente ndërmjet tyre.

Neni 49

Ndryshimi në Konventë

1. Teksti i çdo amendimi rekomanduar te Palët Kontraktuese nga Komiteti Administrativ në përputhje me paragrafin 1(b) të nenit 45, do t'i komunikohet nga Sekretari i Përgjithshëm të gjitha Palëve Kontraktuese dhe atyre anëtarëve të Këshillit të cilët nuk janë Palë Kontraktuese.

2. Çdo amendim i propozuar për këtë Konventë do të hyjë në fuqi tre muaj pas skadimit të periudhës së 24 muajve nga data e komunikimit të amendimeve të propozuara në përputhje me paragrafin 1 të këtij neni, kushtëzuar se asnjë kundërshtim për amendimin e propozuar nuk është komunikuar nga një Palë Kontraktuese te Sekretari i Përgjithshëm gjatë kësaj periudhe.

3. Nëse një kundërshtim mbi ndryshimet e propozuara është depozituar nga një Palë Kontraktuese përpara skadimit të periudhës prej 24 muajsh të specifikuar në paragrafin 2 të këtij neni, amendimi konsiderohet se nuk është pranuar.

Neni 50

Zgjidhja e mosmarëveshjeve

1. Pa paragjykuar paragrafin 1(c) të nenit 45, çdo mosmarëveshje ndërmjet dy apo më tepër administratash doganore lidhur me interpretimin apo zbatimin e kësaj Konvente do të zgjidhet për aq sa është e mundur, me negociata ndërmjet tyre.

2. Çdo mosmarëveshje që nuk zgjidhet me negociata do t'i referohet nga Palët Kontraktuese Komitetit Administrativ, i cili do të marrë në konsideratë mosmarëveshjen dhe do bëjë rekomandime për zgjidhjen e saj.

3. Palët Kontraktuese në mosmarëveshje mund të bien dakord për të pranuar rekomandimet e Komitetit Administrativ si detyruese.

4. Mosmarëveshjet për të cilat nuk është gjetur zgjidhje do të zgjidhen me rrugë diplomatike.

Neni 51

Hyrja në fuqi

1. Kjo Konventë do të hyjë në fuqi tre muaj pasi pesë nga entitetet e referuara në paragrafin 1 dhe 3 të nenit 46 kanë firmosur Konventën pa rezerva ratifikimi ose kanë depozituar instrumentet e tyre të ratifikimit apo pranimit.

2. Pas hyrjes në fuqi në përputhje me paragrafin 1 të këtij neni, kjo Konventë do të hyjë në fuqi, për çdo Palë tjetër Kontraktuese, tre muaj pasi kjo të jetë bërë Palë Kontraktuese në përputhje me dispozitat e nenit 46.

Neni 52

Denoncimi

1. Kjo Konventë është e një kohëzgjatjeje të pakufizuar, por çdo Palë Kontraktuese mund ta denoncojë atë në çdo kohë pas hyrjes së saj në fuqi sipas nenit 51.

2. Denoncimi do të njoftohet me shkrim dhe depozitohet te depozitari.

3. Denoncimi do të ketë efekt gjashtë muaj pas marrjes së instrumentit të denoncimit te depozitari.

Neni 53

Depozitari i Konventës

1. Kjo Konventë, të gjitha firmosjet me ose pa rezerva ratifikimi dhe të gjitha instrumentet e ratifikimit apo pranimit do të depozitohen te Sekretari i Përgjithshëm.

2. Depozitari:

a) do të marrë dhe ketë nën përgjegjësi tekstet origjinale të kësaj Konvente;

b) do të përgatisë kopje të certifikuara të teksteve origjinale të kësaj Konvente dhe do t'ua transmetojë ato Palëve Kontraktuese dhe atyre anëtarëve të Këshillit të cilët nuk janë Palë Kontraktuese dhe Sekretarit të Përgjithshëm të Kombeve të Bashkuara;

c) do të marrë çdo firmosje me ose pa rezerva të ratifikimit, ratifikimin ose hyrjen në këtë Konventë dhe do të marrë dhe mbajë nën përgjegjësi instrumentet, njoftimet dhe komunikimet e lidhura me të;

d) do të marrë dhe mbajë nën përgjegjësi dispozitat ligjore dhe administrative dhe deklaratat e shkruara në respekt të paragrafit 4 të nenit 25;

e) do të marrë dhe mbajë nën përgjegjësi njoftimet dhe rezervat e Palëve Kontraktuese në përputhje me nenin 43;

f) do të ekzaminojë nëse firmat ose çdo instrument, njoftim apo komunikim i lidhur me këtë Konventë është i përshatshëm, në formën e duhur dhe, nëse është e nevojshme, të sjellë çështjen në vëmendje të Palës Kontraktuese të interesuar;

g) do të njoftojë Palët Kontraktuese, ata anëtarë të Këshillit që nuk janë Palë Kontraktuese dhe Sekretarin e Përgjithshëm të Kombeve të Bashkuara mbi:

- datën e hyrjes në fuqi të kësaj Konvente në përputhje me nenin 51 të kësaj Konvente;

- njoftimet e marra në përputhje me nenet 43, 46, 47 dhe 51 të kësaj Konvente;

- denoncimet sipas nenit 52 të kësaj Konvente;

- çdo amendim të pranuar apo kundërshtuar në përputhje me nenin 49 të kësaj Konvente dhe datën e hyrjes në fuqi dhe

- çdo vendim të marrë nga Komiteti Administrativ referuar sipas paragrafit 2 të nenit 45;

h) njoftojë Palët Kontraktuese mbi autoritetet e referuara në paragrafin 3 të nenit 2;

i) njoftojë administratat doganore mbi pikat e kontaktit zyrtar referuar në paragrafin 1 të nenit

3.

3. Në rast të ndonjë mosmarëveshjeje të paraqitur ndërmjet një Palë Kontraktuese dhe depozitarit lidhur me performancën e funksionit të kësaj të fundit, depozitari ose ajo Palë Kontraktuese do ta sjellë këtë çështje në vëmendje të Palëve të tjera Kontraktuese dhe të firmosesve ose, sipas rastit, te Komiteti Administrativ.

Neni 54

Regjistrimi dhe tekstet autentike

Në përputhje me nenin 102 të Kartës së Kombeve të Bashkuara, kjo Konventë do të regjistrohet te Sekretariati i Kombeve të Bashkuara sipas kërkesës së Sekretarit të Përgjithshëm.

Dëshmitarë për sa më sipër, të poshtëshënuarit, të autorizuar përkatësisht, kanë firmosur këtë Konventë.

Bërë në Bruksel, më 27 qershor 2003 në anglisht dhe frëngjisht, të dyja tekstet njëlloj autentike, në një kopje të vetme që depozitohet te Sekretari i Përgjithshëm, i cili do t'i transmetojë kopje të vërtetuara të gjitha entiteve të përmendura në paragrafët 1 dhe 3 të nenit 46 të kësaj Konvente.